Kronikë

Durrës/ Kanosi borxhliun për 1200 euro dhe i grabiti makinën, 'Debt' prangos 37-vjeçarin e kërkuar! I gjenden drogë dhe municion (EMRI+VIDEO)

I arrestuari dy javë më parë, kanosi një shtetas dhe i mori automjetin, sepse pretendonte se i kishte borxh një shumë parash. Sekuestrohen dozat e lëndës narkotike, 1 peshore elektronike dhe municioni luftarak. Dyshohet si i përfshirë edhe në aktivitetin e shitjes së lëndëve narkotike

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
31 Janar, 13:11 | **Përditesimi: 31 Janar, 13:33**

Share

Durrës- Policia e Durrësit arrestoi sot një 37-vjeçar të kërkuar, i cili akuzohej se kishte kanosur për shkak të një borxhi 1200 euro të pashlyer një person, duke i marrë me forcë edhe automjetin.

Burime zyrtare bënë me dije sot se lokalizuan dhe prangosën sot (31 Janar), të dyshuarin Ergys Vogli, gjatë operacionit të koduar "Debt".

Ngjarja kishte ndodhur dy javë më parë. Në momentin e ndalimit, në banesën e këtij shtetasi u gjetën një sasi kanabisi e ndarë në doza gati për shitje, dhe një sasi municioni luftarak.



LEXO EDHE:
Përmbytjet në Durrës prekin edhe burgun, 40 të paraburgosur zhvendosen në qelitë e Fushë Krujës

Si prova u sekuestruan dozat e lëndës narkotike, 1 peshore elektronike dhe municioni luftarak. Operacioni u bë nga forcat 'Shqiponja' dhe Sektori Kundër Krimit dhe Narkotikëve.

> *"Gjatë operacionit u vu në pranga shtetasi E. V., 37 vjeç (Ergys Vogli), banues në Durrës, pasi dyshohet se më datë 17 Janar 2025, me anë të kanosjes dhe shtrëngimit, i ka marrë automjetin një shtetasi, sepse pretendonte se ky i fundit i kishte borxh 1200 euro", bën me dije policia vendore.*

Gazetari i Report TV, Artur Korriku, informon se droga dhe municioni u sekuestruan si prova materiale, kurse dosja i kaloi prokurorisë vendore për veprime të mëtejshme.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Durres | kanosje | Ergys Vogli | arrestim

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni gjendjen e sigurisë në vend?
1 Shkurt, 08:43
Pozitive | Negative | I dyzuar

Lajme të tjera

Vendoset eksploziv jashtë banesës së një 51-vjeçari në Nikël! Lënda nuk ka shpërthyer, sekuestrohet nga policia
Julian Shota
1 Shkurt, 17:19

VIDEO/ Tension në 'Niko Dovana', tifozët e Tiranës dhe AF Elbasanit tentojnë përplasjen fizike! Ndërhyn policia
1 Shkurt, 16:54

Përndiqte 4 të mitura vazhdimisht, arrestohet 41-vjeçari nga Fushë-Kruja! Në hetim dhe një 35-vjeçar pasagjer në makinën e të arrestuarit
1 Shkurt, 16:11

Parku Arkeologjik dhe mozaikët e Durrësit 50 vjet më parë -Kujtimet e teknikut adoleshent, Fred Shuke
Gëzim Kabashi
1 Shkurt, 14:49

Durrës/ Çahet argjinatura e kanalit të Porto-Romanos, banorët akuzojnë firmën dhe kërkojnë ndërhyrje: Rrezikohet katastrofa, të ndërhyhet
31 Janar, 14:13

KPA lë në fuqi shkarkimin e prokurorit të Durrësit Ilir Turja
30 Janar, 21:11

Durrës/ 300 banesa të përmbytura, evakuohen 6 familje, akomodohen te Konvaleshenca! 40 ha tokë nën ujë! FOTOT ME DRON
30 Janar, 08:44

Shiu përmbyt Durrësin/ Situatë problematike në Shkozet e rruga 'Bisht Kamza'! 40 shtëpi nën ujë, shpëtohen 4 fëmijë të bllokuar në furgonin e shkollës (VIDEO + FOTO)
29 Janar, 13:31

Durrës/ I dënuar për tentativë vjedhjeje dhe i dyshuar për plagosje, arrestohet 28-vjeçari i kërkuar (EMRI)
29 Janar, 13:11

Kërcënoi me armë një person gjatë një konflikti, arrestohet 30 vjeçari në Durrës (EMRI)
29 Janar, 11:50

Gjirokastër/ Arrestohen 2 persona, i kërkuan 2000 euro një 40-vjeçareje për t'i fshirë foto intime nga TikTok-u
28 Janar, 12:55

Durrës/ Aksident në mbikalimin e Shkozetit, manovra e gabuar përplas disa automjete
28 Janar, 10:04

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje